




Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhje Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës Zgjedhore Nr. 01/2020 për Fletëvotimet dhe Broshurat, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 14.09.2021, nxjerr këtë:



**V E N D I M**

**Për Miratimin e Rekomandimit për Numrin e Fletëvotimeve dhe Broshurave për Zgjedhjet Lokale 2021**

- I. Miratohet Rekomandimi i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore për numrin e fletëvotimeve dhe broshurave që do të shtypen për zgjedhjet lokale 2021.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 14.09.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Data / Datum	13.09.2021
Për / Za	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
Nga / Od	Burim Ahmetaj - Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së
Kopje / Kopija	Arkives së KQZ-së
Lënda / Predmet	Rekomandim për miratimin e numrit të fletëvotimeve dhe broshurave për zgjedhjet lokale 2021

Të nderuar Anëtarë,

Konform Planit Operacional, bazuar në Rregullën 01/2020 për Fletëvotimet dhe Broshurat, Sekretariati ka përpiluar dokumentin me numrin e fletëvotimeve dhe broshurave që rekomandohet të shtypen për zgjedhjet lokale që do të mbahen me datë 17 tetor 2021.

I. Rekomandimi për numrin e fletëvotimeve

Numri i fletëvotimeve që propozohet të shtypen është 1698600 fletëvotime për zgjedhjet për Kryetar Komune dhe 1698600 për Zgjedhjet për Kuvende Komunale. Ndërsa modaliteti i propozuar është:

a) në vendvotimet e rregullta shtypen fletëvotime me pak se votues nga -100 deri në -149

Vendvotimi	Numri i votuesve	Numri i fletëvotimeve në vendvotim (rrumbullakimi)
0101C/01R	854	750

*Tabela 1. Shembull i kalkulimit të fletëvotimeve në vendvotimin e rregullt*

b) në vendvotimet e dyfishta, shtypen fletëvotime me pak se votues nga -1 deri në -49

Vendvotimi	Numri i votuesve	Numri i fletëvotimeve në vendvotim (rrumbullakimi)
0101C/04D	830	800

*Tabela 2. Shembull i kalkulimit të fletëvotimeve në vendvotimin e dyfishtë*

c) fletëvotimet rezervë shtypen duke kalkuluar 2 % e numrit të votuesve në nivel të komunës dhe rrumbullaksohet me kufirin e poshtëm sikurse tek fletëvotimet në vendvotimet e dyfishta (pika b).

d) për ekipet e VPNV-ve, kategoria e dytë, numri është përcaktuar nga Divizioni i Shërbimit votues sipas vlerësimeve nga zgjedhjet e kaluara.

Bazuar në Listën Përfundimtare të Votuesve, votues me të drejtë vote për keto zgjedhje janë 1885448 votues, ndërsa do të shtypen 1698600 fletëvotime për zgjedhjet për kryetar komune dhe 1698600 për kuvende komunale, gjithsej 3397200 fletëvotime. Rrjedhimisht i bie që do të shtypen 186848 apo 9.91 % fletëvotime më pak se votues secilin për secilin nivel të zgjedhjeve.

## II. Rekomandimi për numrin e broshurave

Numri i broshurave të kandidatëve që propozohet të shtypen është 16742 broshura. Ky numër derivon nga modaliteti i propozuar si në vijim:

- a) Për secilin vendvotim shtypën dhe dërgohen nga 6 broshura, e që i bie 14862 broshura. Numri i broshurave rezervë që shtypen dhe dërgohen në KKZ është dy broshura për secilën qendër të votimit. Kjo përveç në komunat që kanë nga një qendër të votimit, ku në këto komuna shtypen nga 5 broshura rezervë. Pra numri i përgjithshëm i broshurave rezervë në KKZ është 1766 broshura.
- b) Për ekipet e VPNV-ve, kategoria e dytë, numri i broshurave të përcaktuar nga Divizioni i Shërbimit votues

Bashkangjitur me këtë shkresë gjeni tabelën përmbledhëse me numrin e fletëvotimeve dhe broshurave që shtypën për zgjedhjet lokale që mbahen me 17 tetor 2021.